



Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k, NIPT J61813529P, me adresë: Lagja 14, Rruga Tirana, Pranë Gjykatës së Apelit, Shkozë, Durrës.

Procedura e prokurimit/lotit: Proçedurë e hapur me mjete elektronike - Mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR. REF- 05343-05-20-2024.

LOTI I: NR. REF- 05351-05-20-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje lëndë djegëse, lloji naftë dhe benzinë për nevojat e KESH sh.a”, i ndarë në LOTE:

LOTI I: “Blerje lëndë djegëse, lloji naftë për nevojat e KESH sh.a”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj ose me mbarimin e vlerës së kontratës.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.27, datë 27/05/2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1) Operatori ekonomik “Kastrati” sh.p.k, NIPT J61813529P, me ofertë ekonomike 25,935,090.21 (Njëzetë e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë pikë njëzetë e një) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Kastrati” sh.p.k, NIPT J61813529P, me adresë: Lagja 14, Rruga Tirana, Pranë Gjykatës së Apelit, Shkozë, Durrës, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 25,935,090.21 (Njëzetë e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë pikë njëzetë e një) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Përsa i përket afateve të ankimit, referuar nenit 96 pika 2 gërma (b) të Ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku citohet se “Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues”, për procedurën e sipërcituar, duke qenë se ka pasur vetëm një ofertues të kualifikuar dhe të shpallur fitues, nuk aplikohet periudha e pritjes.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erlind Sulo